



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr 2202/ prot.

Tiranë, më 03.09 2024

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr. 3024 prot., datë 31.07.2024.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës nr. 3024 prot., datë 31.07.2024, nëpërmjet së cilës kërkohet caktimi i përfaqësuesve/ekspertëve të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si pjesë e nëngrupit të ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik, që do të funksionojnë pranë komisionit të posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, duke mbajtur në konsideratë jo vetëm faktin se krijimi i raporteve të balancuara ndërmjet institucioneve publike duhet të orientohet nga standardi kushtetues i bashkëpunimit, por edhe në vlerësim të rolit koordinues të Kuvendit në kuadër të procesit të integritetit evropian të vendit, ILD në përputhje me rolin, funksionin e tij kushtetues dhe mundësitë objektive shpreh gadishmërinë për të kontribuar në çdo nismë, e cila ka për qëllim respektimin e të drejtave themelore të njeriut, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të reformës në drejtësi në Shqipëri.

Por, për sa edhe ka parashtruar në mënyrë të vazhdueshme gjatë raportimeve periodike pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është duke u përballur me mungesë të vazhdueshme të burimeve njerëzore. Në këto kushte, kontributi i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë moment, mund të sigurohet vetëm nëpërmjet shkëmbimit të informacionit apo të dhënave të nevojshme në kuadër të procesit të punës së komisionit të posaçëm parlamentar.

Në këtë kuadër, në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana juaj, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të caktojë Znj. Eljona Bylykbashi me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me adresë të postës elektronike eljona.bylykbashi@ild.al, si personin përgjegjës për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit apo të dhënave të tjera ndërmjet Komisionit dhe institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur METANI

